



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

V E N D I M

NR. 3/10 DATË 02 / 12 / 2021

PËR

SHTYRJEN E VENDIMMARRJES MBI KËRKESËN E SUBJEKTIT INVESTUES, SHOQËRISË "AQUATIQ" SH.P.K. PËR KORRIGJIMIN E NJË GABIMI MATERIAL NË ZBARDHJEN E VENDIMIT NR. 3/8 DATË 15.07.2021 TË KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE "PËR MIRATIMIN E STATUSIT TË INVESTITORIT STRATEGJIK PËR REALIZMIN E "FERMËS AKUAPONIKE"

Në mbështetje të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike, me propozim të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA),

KONSTATOISE:

- Projekti “Fermë Akuaponike” propozuar nga subjekti "Aquatiq" sh.p.k., ka përfituar statusin “Investim/Investitor strategjik, procedurë e asistuar” me Vendim të Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS) Nr. 3/8, datë 15.07.2021.
- Zhvillimi i fermës akuaponike prej 146 ha synon të përfshijë disa faza, ku faza e parë pritet të jetë ajo e ndërtimit të fermës fillestare prej 12.25 ha, e cila përbëhet nga disa zona prodhimi (2.75 ha secila zonë) dhe po kështu edhe sipërfaqet e fermave pasardhëse.
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) ka konfirmuar parcela të lira në zonën e kërkuar DJ_B_B_1, Karavasta e Re.
- Masa mbështetëse që i është miratuar subjektit me Vendim të KIS Nr. 3/8, datë 15.07.2021 është dhënia në përdorim e pasurisë së paluajtshme në pronësi të shtetit me sipërfaqe përafërsisht 100 ha, nën administrim të MBZHR.
- Subjekti, pasi është vënë në dijeni të Vendimit të KIS Nr. 3/8, datë 15.07.2021, me

shkresën Nr. 3/1 Prot. datë 15.11.2021 drejtuar Komitetit të Investimeve Strategjike, pretendon se në këtë Vendim, ka një gabim material dhe kërkon që me vendim të KIS të miratohen 27 parcela të zonës DJ_B_B1 me një sipërfaqe totale prej 326 ha (sipërfaqe referuar PDZRK Karavasta), ku në këto parcela përfshihen edhe hapësirat ndihmëse dhe ndërlidhëse midis këtyre serave, si rrugë, parkim, kanale, rrjet teknik furnizues midis tyre me qëllim ndërtimin e 146 ha sera (gjurmë ndërtimi/sipërfaqe neto) me vlerë investimi 26 milion Euro dhe krijimin e 1500 vendeve pune.

Në përfundim, pasi u njoh me pretendimin e subjektit, me kërkesë të ministrit përgjegjës për bujqësinë dhe zhvillimin rural, në cilësinë e anëtarit të KIS dhe me dakordësi të anëtarëve të tjerë, me qëllim njohjen me dokumentacionin e plotë të projektit në fjalë dhe vlerësimin e pretendimit të subjektit,

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDOSI:

1. Shtyrjen e vendimmarrjes, për mbledhjen e radhës së Komitetit të Investimeve Strategjike, mbi kërkesën e subjektit "Aquatiq" sh.p.k. për korrigjimin e një gabimi material në zbardhjen e Vendimit Nr. 3/8 datë 15.07.2021 të Komitetit të Investimeve Strategjike "Për miratimin e Statusit të Investitorit Strategjik për realizimin e "Fermës Akuoponike".
2. Subjekti të vijojë realizimin e fazave të projektit në sipërfaqen prej afërsisht 100 ha, në pronësi të shtetit shqiptar, të miratuar sipas Vendimit të KIS Nr.3/8, datë 15.07.2021.
3. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për njoftimin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTRI

EDI RAMA